



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1028/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “O...” Shpk me seli në Malishevë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Z.A., avokat në Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.440/20 të datës 06.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.04.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.440/20 të datës 06.09.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.440/20 të datës 06.09.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “O...” Shpk me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është anuluar aktvendimi me nr.06.2/945-2017 i datës 21.01.2020, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “O...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, t’ia kthej detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese, në vlerë prej 756.42€ (shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro, e dyzet e dy cent), të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratës Unike Doganore R-55623/23.11.2016 në ZBD Prishtinë, si dhe t’ia paguaj kamatën vjetore ligjore prej 8% nga data kur është bërë pagesa e detyrimeve doganore e deri në përmbushjen e definitive të detyrimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si të bazuar me ligj, të prishet aktgjykimi A.nr.440/20 i datës 06.09.2021 si të pa bazuar me ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të pabazuar me ligj dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar si të ligjshëm ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.06.2/945-2017 të datës 21.01.2020, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë "O..." Sh.p.k me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit nr. R-55623/23.11.2016 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtinë.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.02.2020, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.06.2/945-2017 të datës 21.01.2020 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se nga administrimi i provave në konflikt administrativ gjykata konstaton se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës, faturën përcjellëse të mallit të datës 21.11.2016, profaturën e datës 19.11.2016, urdhërpagesën ndërkombëtare të datës 22.11.2016 në ... Bank, e

cila pagesë harmonizohet me vlerën e deklaruar të mallit lëndor sipas profaturës dhe faturës së mallit lëndor me të cilat dokumente është deklaruar dhe zhdoganuar malli lëndor, e të cilat dokumentacione janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109, andaj gjykata konstaton se janë përmbush kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturës së mallit të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore R-55623/23.11.2016 të ZBD Prishtinë. Gjykata konstaton se malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 respektivisht sipas vlerës së transaksionit që paraqet çmimin e vërtet të paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë. Po ashtu nga provat e administruara dhe arsyetimi i vendimit kontestues gjykata nuk ka gjetur asnjë provë konkrete që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura nuk e ka mbështetur konstatimin e vet në asnjë dispozitë ligjore që do të përcaktonte se të dhënat e disponueshme dhe dosja e vlerës janë çmime obligative duke e anashkaluar dokumentacionin që ka paraqit paditësi, që në këtë rast dëshmon se është paguar vlera e transaksionit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave 03/L-109, por duke i anashkaluar dëshmitë mbi pagesën e vlerës së mallit përmes transferit bankar e paditura vlerëson mallin me metodën e fundit të vlerësimit. Një vlerësim i tillë i dokumentacionit nga e paditura me aplikim të metodës së 6 të vlerësimit nenit 35 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës është i pa pranueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-

së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata nuk ka administruar provat për të vërtetuar gjendjen faktike por vetëm i ka përmendur ato dhe ka nxjerr konkluzion të gabuar duke e aprovuar padinë e paditësit. Po ashtu aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave materiale, respektivisht nenit 34 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, pasi që në nenin e përmendur është paraparë se Dogana e Kosovës për vlerën e mallrave të importuara, kur nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 dhe 34, çmimet e mallrave do të përcaktohen në bazë të të dhënave sipas renditjes kronologjike të nën paragrafëve të dispozitave të KDA-së. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike, për faktin se e paditura nuk ka arsyetuar pretendimin se përse vlerësimi nuk mund të bëhet me metodën e parë të vlerësimit në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109, nuk është dhënë asnjë provë për tu dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës së mallit. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.22.17 të datës 09.10.2019 është aprovuar ankesa e paditësit dhe është anuluar vendimi i të paditurës dhe lënda është kthyer në ri rivendosje, me asrjet se në riprocedurë nga e paditura duhet të deklarohet lidhur me provat e paraqitura nga paditësi dhe të administruara si provë nga gjykata si fatura e mallit, transaksioni bankar, ashtu që të konstatoj se a ka paraqit paditësi dokumentacionin përcjellës të mallit të nevojshëm që kërkohet me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009. Po ashtu e paditura në ri procedurë të sqaroj se cila bazë ligjore kërkon që dokumentacionit përcjellës të mallit duhet bashkangjitur kontrata e shitblerjes. Gjykata edhe pse i ka bërë me dije të paditurës se është e papranueshme të mos shqyrtohen pretendimet ankimore lidhur me validitetin e dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, vetëm për arsyen se e paditura posedon të dhëna të disponueshme nga dosja e vlerës. Mirëpo në rastin konkret e paditura i është shmangur këtij rekomandimi dhe vërejtjeve të gjykatës për mos anashkalim të metodave të vlerësimit pa u vërtetuar gjendja faktike e dokumentacionit të mallit lëndor se është paguar vlera e transaksionit sipas profaturës, faturës së mallit lëndor, transaksionit bankar konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Gjykata e shkallës së parë ka poseduar me prova të mjaftueshme për të

vendos në mënyrë meritore në pajtim me nenin 81.I paragrafi 2 pika 2.2 të Ligjit nr. 04/L-102, nenit 46 paragrafi 4 të LKA-së. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar edhe bazën ligjore sa i përket dokumenteve që parashihet ti bashkëngjiten DUD-ave gjatë zhdoganimit të mallit, të cilat me të drejtë ka vlerësuar se provat e paraqitura nga paditësi janë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore sa i përket vlerës së transaksionit për pagesën e faturës së mallit lëndor në kuptim të nenit 33 të KDAK-së.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1028/22, me datë 13.04.2023

Kryetare kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri